



Departamenti i Prokurimit

Prishtine : datë, 23.06.2020

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 19.06.2020 të parashtruar nga Operatori Ekonomik “Swismed”, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me material shpenzues laboratorik dhe mjekësor LLOT V”, me Nr. të Prok: 616 20 16 111 nxjerr:

V E N D I M

1. **Refuzohet** kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik të “Swismed” të dt. 19.06.2020 lidhur me aktivitetin e prokurimit “ Furnizim me material shpenzues laboratorik dhe mjekësor LLOT V, me Nr616 20 16 111 kundër Njoftimit për dhënie të Kontratës te AK – së, të datës 17.06.2020 te publikuar ne web-faqe te KRPP-së .
2. **Vërtetohet** vendimi i AK për [dhënien e kontratës] të publikuar me datë: 17.06.2020;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që te vazhdoj me aktivitetin e prokurimit;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik Swismed me datë 19.06.2020, ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “**Furnizim me material shpenzues laboratorik dhe mjekësor LLOT V**” me Nr. të Prok: Nr 616 20 16 111 . Autoriteti Kontraktues, me datë 23.06.2020, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

1. Autoriteti Kontraktues nuk ka kërkuar Autorizim te prodhuesit (me rekomandimin e KRPP-se), por ka paraqitur pershkrimet e sakta per cdo artikull te kerkuar;
2. Bazuar ne kerkesat e FDT-se ne kemi pranuar oferte me cmim me te ulet dhe nga prodhuesi i njejte per te cilin ju pretendoni se jeni te autorizuar; dhe

3. Per produktin e njejte Autoriteti Kontraktues bazuar ne kriterin e dhene cmimi me i ulet normalisht se ka pranuar oferten e tenderuesit tjetër.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.



Zyrtari përgjegjës i Prokurimit